

Të nderuar Prindër

Ju gjendeni në një pozitë delikate për Ju dhe fëmijët tuaj dhe nuk e dini si të veproni pas procedimit të çështjes gjyqësore me familjen tuaj. Ju dëshironi përfundim të shpejtë të marrëveshjeve familjare dhe një vendimi të drejtë të Gjykatës. Pikë e madhe e konfliktit shpesh është interesi i fëmijut.

Jo çdoherë për prindërit dhe Gjykatën është e qartë, ku do të jetojnë fëmijët dhe kush do të kujdeset, që ata të zhvillohen drejtë. Në qoftë se Gjykata kërkon bazë më të gjerë për vendim, ajo për ekspertizë mund të emërojë një ekspert nga fusha psikiatriko-psikologjike për përpilimin e një raporti.

Qëllimi i një vlerësimi nuk është për të përcaktuar një prindër "të mirë" ose "të keq", por për të detektuar se cilat janë nevojat individuale të fëmijës që të mundësojë një zhvillim të shëndetshëm dhe në çfarë kushte kjo mund të arrihet dhe garantohet më së miri. Ekspertët janë profesionistë të cilët mund të kontrollojnë fëmijun tuaj. Prandaj një vlerësim për fëmijën tuaj zakonisht nuk është barrë për atë.

Vlerësuesi duhet të kontrollojë fëmijën individualisht gjithashtu edhe për marrëdhënien e tij me Ju si prindër si dhe në aspekte të rëndësishme për zhvillimin e tij, kështu për shembull gjendja e tij zhvillimore, me shikim në funksionet tuaja prindërore. Vlerësuesi ruan neutralitetin ndaj prindërve dhe drejton vëmendjen e tij për mirëqenien e fëmijës.

Në raportin - intervistën e parë, Juve si prindër do të ju sqarohet në hollësi procesi i vlerësimit profesional dhe Ju keni mundësinë të bëni pyetje për procedurën. Pas një analize të dokumentacionit do të bisedohet, edhe atë me prindërit dhe me fëmijët si dhe me kujdestarët edukativ dhe terapeutët, me pediatrin, këshilltarët dhe drjetoritë e përfshira sociale. Përveç kësaj do të bëhen vëzhgime mbi marrëdhëniet në mes prindërit dhe fëmijut, do të kryhen teste psikologjike, dhe shpeshherë bëhet edhe një vizitë në shtëpi. Pas përfundimit të të gjitha kontrollimeve Ju si prindër do të noftoheni për rezultatet dhe do të ju jepen rekomandimet e nevojshme.

Pas kësaj Gjykata, së bashku me Ju si prindër do të mundohet të gjejë zgjidhje më të mirë për fëmijun tuaj. Nëse prindërit refuzojnë këtë, Gjykata do të sjell një vendim.

Bashkëpunimi i mirë në mes të gjitha palëve të përfshira do të ndihmojnë për të shkurtuar procedurat.

Harxhimet për ekspertizën do të llogariten sipas sipas vështirësis dhe do të barten nga prindërit, nëse ata nuk janë nevojtarë.